



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 57, datë 20.04.2021

PËR

**MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 4' 995' 416 ( KATËRMILION E NËNTËQIND E NËNTËDHJETË E PESË E KATËRQIND E GJASHTËMBJEDHJETË) LEKË ME TVSH, PËR FAMILJET E DËMTUARA SI REZULTAT I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR E OBJEKTEVE/NDËRTESAVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 3, TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS LISTËS BASHKËNGJITUR**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me Urdhërin e zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.419, datë 29.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit për dëmet e shkaktuara në ndërtesat pronë private, nga prishja e detyruar me demolim (tritol)” i ndryshuar dhe Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4'995'416 (katërmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e katërqind e gjashtëmbjedhjetë) lekë me TVSH, për familjet e dëmtuara si rezultat i

dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar e objekteve/ndërtesave në Njësinë Administrative nr.3, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas listës bashkëngjitur.

2. Miratimin e dërgimit të listës së përfituesve me vlerat përkatëse të dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar e objekteve/ndërtesave në Njësinë Administrative nr.3, si dhe dokumentacionin shoqëruar pranë Ministrisë së Rindërtimit për dhënien e fondit me vlerë 4'995'416 (katërmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e katërqind e gjashtëmbjedhjetë) lekë me TVSH, për shkak të pamundësisë për t'u mbuluar këto fonde nga ana e Bashkisë Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile si dhe Drejtoria e Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 20.04.2021**

Lista përmbledhëse me vlerësimet respektive të kryera nga Komisioni i Konstatimit i ngritur me urdhërin nr.01, datë 06.01.2021

Nr	Emër Mbiemër	Vlera sipas preventivit pa tvsh	Vlera sipas preventivit me tvsh	Shënime
1	Admir Domi	12,578	15,093	
2	Alked Aruci	51,821	62,185	
3	Bubulina Golgota	561,288	673,545	
4	Ermioni Goga	61,957	74,349	
5	Ermir Mehmeti	266,664	319,997	
6	Ermira Demiraj	33,658	40,389	
7	Fatmir Avdyli	74,682	89,619	
8	Ferdinant Hila	4,094	4,913	
9	Flutur Fetahu	26,561	31,873	
10	Gazmend Alibejsi	21,749	26,099	
11	Groso Pronjari	36,205	43,445	
12	Jorgji Cuni	329,289	395,146	
13	Landa Ziu	50,180	60,216	
14	Leonora Koça	2,478	2,974	
15	Lluka Iutra	123,422	148,107	
16	Malvina Cani	482,840	629,408	Vlera totale me tvsh 879,408. Vlera pa tvsh 732,840. Trajtuar me grandin e rindertimit duke e zbritur si vlere te perfituar 250,000 përfitimi nga grandit DS2, e sugjeruar nga Komisioni I vleresimit.
17	Marije Golgota	185,701	222,841	
18	Olsi Shaholli	35,445	42,534	
19	Polikron Pilinci	106,953	128,344	
20	Sami Rama	74,709	89,651	
21	Silvana Shehu	57,908	69,490	
22	Sokol Stafa	45,610	54,731	
23	Valbona Rama	83,458	100,150	
24	Vangjeli Milja	195,655	234,786	
25	Vasil Ziu	97,422	116,907	
26	Vjollca Muca	47,468	56,961	
27	Xhenela Sulejmani	32,077	38,493	
28	Enkelejda Rama	19,675	23,610	
29	Miranda Ibrahimimi	34,553	41,463	
30	Pandeli Rroqa	140,835	169,002	
31	Artur Arapi	18,562	22,275	
32	Ergest Hoxhaj	82,795	99,354	
33	Hekuran Bici	10,928	13,114	
34	Lulzim Gjuzi	28,353	34,024	
35	Elisabeta Velaj	83,575	100,290	
36	Ana Bello	194,530	233,436	
37	Lirije Qamo	33,273	39,928	
38	Spartak Rigo	183,515	227,156	
39	Valbona Zyko	89,322	107,187	
40	Selfo Abdurraman	93,609	112,331	
	<b>Total vlera</b>	<b>4,115,397</b>	<b>4,995,416</b>	

Komisioni i konstatimit të dëmeve i ngritur me urdhër nr.01, datë 06.01.2021

Pasho Beqiri - Kryetar  
Enea Kula - Anëtar  
Luza Nikolla - Anëtar






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 287 / prot.  
2



Durrës, më 20.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 57 datë 20.04.2021 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4’995’416 ( katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëmbjdhjetë) lekë me tvsh, për familjet e dëmtuara si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar e objekteve/ndërtesave në njësinë administrative nr. 3, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas listës bashkëngjitur”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

